




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



THIRRJE PËR APLIKIM

**Përkrahja e fermerëve me preparate për
luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së
rrushit**

Rahovec, Mars 2024

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural fton të gjithë fermerët e Komunës së Rahovecit që të aplikojnë për preparate për luftimin e insektit cikadia e hardhisë së rrushit.

• Sektori i cili do të përkrahët përmes kësaj thirrje është:

- Vreshtarisë

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e preparatit janë:

- Të jetë banor i Komunës së Rahovecit,
- Të jetë fermerë i regjistruar (NIF)
- Të ketë të shlyera obligimet ndaj Komunës,
- Të posedojë sipërfaqe me vreshta në pronësi apo të marr me qira,
- Të jetë i gatshëm në kohën e duhur të bëjë trajtimin kundër insekteve.

Kriteret specifike që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e preparatit janë:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të jetë fermer/fermere, kultivues i rrushit.
- Të ketë së paku **0.10 ha** me vreshta.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni (merret online ose në zyrat e DBPZHR-së),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Vërtetim mbi shlyerjen e obligimeve ndaj Komunës së Rahovecit (Tatim në pronë dhe taksë komunale).

Vërejtje:

- *Përkrahja do të jetë 100% nga Komuna e Rahovecit,*
- *Pasi të shpallen përfituesit, të gjithë fermerët janë të obliguar që ta kryejnë trajtimin e vreshtit.*
- *Verifikimi i përzgjedhjes së përfituesve do të bazohet në aplikacionet për pagesa direkte të vitit 2023.*

Afati i aplikimit nga data: **06.03.2024** deri më **20.03.2024**

Aplikacionet dorëzohen në drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.